



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0800

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) si dhe nenit 29 dhe 31 të Rregullores së Punës, në përbërje nga Isa Hasani-kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Arch Empire” L.L.C., kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit të Policia e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbime Profesionale Inxhinierike -Ritender” me numër të prokurimit 214-23-6903-2-2-1, me 15/01/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE “Arch Empire” L.L.C. me nr; 2023/0800, e datës 16/10/2023, kundër” Njoftim Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues” AK Policia e Kosovës, i datës, 27.9.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbime Profesionale Inxhinierike -Ritender” me numër 214-23-6903-2-2-1.
2. Anulohet” Njoftim Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, aktiviteti prokurimit numër; 214-23-6903-2-2-1, datës, 27.9.2023 dhe lënda kthehet në Rivlerësim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 17.07.2023, Policia e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Shërbime Profesionale Inxhinierike -Ritender”, me numër të prokurimit 214-23-6903-2-2-1. Ndërsa me datën

27.09.2023 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për shërbime dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 90,000.00 €.

Me 01.10.2023, OE “Arch Empire” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 05.10.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 16.10.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Arch Empire” SH.P.K., me nr. 800/23 lidhur me aktivitetin “Shërbime Profesionale Inxhinierike -Ritender”, me numër të prokurimit 214-23-6903-2-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraparak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprahe për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Arch Empire" SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi Ankuesi pretendon se “Grupi ynë i OE-ve “Arch Empire LLC” dhe “Eng Idea” shpk është marr vendim te eliminohet me arsyetimin si ne vijim: Tenderi juaj është i pa përgjegjshëm, sepse nuk keni dërguar: AK ka kërkuar qe OE duhet te ketë pajisje për matje gjeodezike GPS. Të dëshmuar me certifikatë të kalibrimit nga kompania e licencuar për kalibrim-valide. Në këtë rast OE certifikatën e kalibrimit nuk ka ofruar valide. Ne fazën e aplikimit ne kemi ofruar paisjen e kërkuar GPS GNSS Rover Kopos me gjithë dokumentacionin e kërkuar ne përputhje me kërkesat ne dosjen e tenderit, përfshi certifikimin e kalibrimit nga kompania e licencuar për kalibrim AGEO & CO shpk - valide. Certifikata e kalibrimit mban datën e certifikimit 19.05.2022. Certifikimi i instrumenteve gjeodezike behet ne periudha periodike te rregullta ne maksimum çdo dy vite, andaj dhe certifikata e ofruar është valide, Pra, nuk qëndron pretendimi i komisionit te AK-se se certifikat e kalibrimit nuk është valide te cilën gjë AK e përsërit edhe ne përgjigjen e kërkesës për Rivlerësim! Nëse Komisioni i AK-se ka pasur paqartësi lidhur me validitetin është dashur te shfrytëzoj nenin 72 te LPP-se për te kërkuar sqarime qe nuk e ka bere! Ne këtë Rast edhe pse kemi bashkangjitur rregulloren e AKK-se për kalibrimin e instrumenteve AK nuk e merr fare ne konsiderate! Bashkangjitur gjeni dokumentin Në mbështetje të paragrafit 6 të nenit 4 dhe paragrafit 2 të nenit 34 të Ligjit Nr. 04/L-013 për Kadastër, paragrafit 5 të nenit 6 dhe paragrafit 5 të nenit 9 të Udhëzimit Administrativ MMPH – Nr. 12/19 për ndarjen dhe regjistrimin e parcelës, paragrafi 5 të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ MMPH – Nr. 11/19 për ndarjen e ndërtesës dhe të pjesës së ndërtesës dhe paragrafi 3 të nenit 7 të Udhëzimit Administrativ MMPH– Nr. 10/19 për matjet kadastrale për regjistrim në kadastrë, Agjencia Kadastrale e Kosovës nxjerrë këtë: Kornizë të punës Nr. AKK 2020/01 për matje, krijim dhe regjistrim të njësive kadastrale (parcelë, ndërtesë dhe pjesë të ndërtesës), ne te cilën pika 20 flete qarte për Certifikimin e instrumenteve gjeodezike. 20. Certifikimi i instrumenteve gjeodezike. Për matje kadastrale mund të përdoren vetëm instrumente të certifikuara. Certifikimi

i instrumenteve matëse duhet të bëhet nga institucioni apo kompania e autorizuar prej prodhuesit të instrumentit. Vërtetimi/certifikatat për instrumentin nuk duhet të jetë më e vjetër se dy vite. Instrumentet për matjet kadastrale të cilat duhet certifikuar janë: 1. Instrumentet GNSS dhe 2. Stacion Total. Gjeodetët e licencuar, kompanitë gjeodete të licencuara dhe tekniku gjeodet i licencuar janë të obliguar që pas dy viteve pasi që është bërë certifikimi i instrumenteve, të njëjtën gjë ta përsërisin dhe certifikatën e re ta dorëzojnë në AKK tek komisioni për licencim. Në të kundërt, d.m.th. nëse nga gjeodetët e licencuar, kompanitë gjeodete të licencuara dhe tekniku gjeodet i licencuar nuk dorëzohet dëshmia për përsëritjen e certifikimit në afatin e caktuar, atëherë automatikisht konsiderohet e pezulluar licenca e tyre deri në plotësimin e kriterit të ricertifikimit. Pra, kjo dëshmon me se miri që arsyeshmeria e Komisionit të AK për eliminimin e grupit tone të OE-ve Arch Empire LLC dhe Eng Idea shpk është në kundërshtim të plotë me ligjet, rregulloret dhe udhëzimet administrative. Pra kjo arsyeshmëri për eliminim është e pasaktë dhe e paqëndrueshme. Megjithatë AK përkundër dëshmisë dhe faktit të bashkangjitur nuk merr fare në konsideratë dhe kërkesën për rivlerësim e refuzon!.

Pretendimi i dytë (II): Ankuesi pretendon se “AK ka eliminuar të gjithë OE-te me arsye të caktuara po nëse do të ndalemi tek dy OE Eng group shpk dhe N.SH. GEO-MAP që kanë çmime dukshëm më të lira se grupi i Arch Empire LLC dhe Eng Idea shpk. Po ju rikujtojmë se vendimi për anulim i të njëjtës procedure prokurimi tani me është marrë për herë të tretë nga AK, pra dy herë më parë është anuluar kjo procedure e prokurimit për shërbime të lartcekura. Anulimi i kësaj procedure të prokurimit me datë 21.06.2023 ka ndodhur mbështetur edhe në vendimin e OSHP-se nr. 2023 0291. Arsyeja e anulimit të procedurës së lartcekur është bërë nga AK me arsyen si më poshtë: Rezultati i aktivitetit të prokurimit: Policia e Kosovës anulon aktivitetin e prokurimit me arsyetimin si në vijim: çmimet e peshuara të ofruara nga dy OE kanë qenë çmime abnormalisht të ultë se çmimet e planifikuara e të peshuara nga AK. U bë i gjithë ky sqarim me sipër pasi që AK në këtë rast nuk ka marrë fare në konsideratë çmimet jonormalit të ulëta të ofruar nga të dy OE-te Eng group shpk dhe N.SH. GEO-MAP. Në njoftimin e vendimit të AK-se se të datës 27.09.2023 janë dhënë arsyetimet e eliminimit të të dy OE te lartcekur por nuk është përfshirë fakti që këta OE përveç arsyeve të dhëna nga AK kanë ofruar po ashtu çmime jonormalit të ulët. Pas qasjes në dokumentacion ku janë verifikuar dhe çmimet e ofruar nga të dy OE Eng group shpk dhe N.SH. GEO-MAP, përveç se vërtetohet se kanë ofruar çmime jonormalisht të ulëta në oferta të tyre ka dhe çmime abuzive. Sqarim: OE GEO MAP në poz.1 Pika A Hartimi i projekteve ideore jep çmimin 5.00 € , ndërsa të gjitha çmimet e tjera përfshi çmimet në piken B hartimi i projekteve kryesore-pale ofron çmime jo normalisht të ulëta. Pra, AK duhet të bëjë vlerësim në bazë të kriterëve që vete ka aplikuar për të njëjtin shërbim. Nëse AK nuk bën vlerësimin se këto dy OE kanë aplikuar me çmime jonormalisht të ulëta për arsye të cilat i cekem më lart, pra ka anuluar procedurën paraprake vetëm për çmime jonormalisht të ulëta pse nuk përdor të njëjtin kriter tani. Në këtë kërkesë për rivlerësim kërkojmë nga AK në përputhje me LPP-ne dhe Udhëzimet administrative të marrë në konsideratë çmimet jo normalisht të ulëta dhe të eliminojë të dy OE-te Eng group shpk dhe N.SH. GEO-MAP edhe për çmimet jo normalisht të ulëta. AK në këtë rast nuk ka aplikuar ligjin konkretisht Neni 61 Tenderët Jo-Normalisht të Ulët Andaj, përmes kërkesës Ankese Kërkojmë nga Organi shqyrtues I Prokurimit ta shqyrtoj vendimin për anulimin e kësaj procedure të prokurimit, ta anuloj këtë vendim (marrë parasysh ligjin dhe RROUPP-ne, sqarimet e lartcekura) të marrë në konsideratë sqarimet tona dhe të shpall njoftimin për vendimin e dhënies së kontratës grupit të OE të përgjegjshëm me çmimin më të ulët që në këtë rast është Arch Empire LLC dhe ENG IDEA shpk, sepse kemi ofertuar me çmime reale të tregut dhe jemi të përgjegjshëm.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE Arch Empire SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 2, 6, 59, 60, 61, 72 të LPP-së duke kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 26.10.2023 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 800/23, ndërsa me datë 30.10.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0800 me rekomandimet si në vijim: *“Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, ndërsa vendimi i AK-së të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim”*.

Lidhur me pretendimet e OE "ARCH EMPIRE" SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0800 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i pare (I): OE ankuesi është eliminuar me arsyetimin: Tenderi i juaj është i pa përgjegjshëm sepse nuk keni dorëzuar: -AK ka kërkuar që OE duhet të ketë pajisje për matje gjeodezike GPS. Të dëshmuar me certifikatë të kalibrimit nga kompania e licencuar për kalibrim-valide. Në këtë rast OE certifikatën e kalibrimit nuk ka ofruar valide. Si dhe AK anulon aktivitetin e prokurimit me arsyen: Policia e Kosovës anulon aktivitetin e prokurimit me arsyetimin si në vijim: Asnjëra prej ofertave të pranuara nuk janë të përgjegjshme. Ekspertja Shqyrtuese sqaron se, AK operatorin ankues ka eliminuar për validitetin e certifikatës, për të cilën I njëjti deklaron se është valide me afat dy vjeçare, si e tillë që të jem sa më objektiv në shqyrtimin e lëndës fillimisht me datë 01.11.2023 kam kërkuar sqarim dhe konfirmim për validitet nga kompania e licencuar e cila ka lëshuar certifikatën e kontrollit, gjithashtu të njëjtën kohë kam kërkuar edhe nga AK që ta na argumentoj refuzimin e kërkesës për rishqyrtim. Tutje, me po të njëjtën datë 01.11.2023 kompania Ageo&CO ka kthyer përgjigje menjëherë duke na sqaruar se validiteti i certifikatës është dy vjeçare sipas kornizës së punës nr AKK 2020/01 për matje pika 20- certifikimi i instrumenteve gjeodezike, përgjigja mëposhtë: “Ne jemi distributor te autorizuar te prodhuesit internacional HI-TARGET dhe certifikata lëshohet në kuptim të nenit 20 të kornizës së punës 2020/01 të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, përkatësisht për licencim të gjeodetit ose kompanisë gjeodete. Me shumë detaje gjeni të bashkangjitur screen jpg për dëshmi se jemi distributor dhe faqen e kornizës së punës ku citohet certifikimi i paisjeve”. Kurse, nga AK me datë 03.11.2023 kemi pranuar përgjigje lidhur me kërkesën për sqarim, si e tillë të njëjtit janë përgjigjur si mëposhtë: “Sa i përket pyetjes së parashtruar nga ekspertja e OSHP, ju njoftojmë se ne si komision i vlerësimit për këtë projekt lidhur me validitetin e pajisjes së GPS jemi bazuar në dokumentet e OE të tjerë pjesëmarrës në këtë tender, se kalibrimi i kësaj pajisje do të bëhet pas 12 muajsh për matje sa ma precize (bashkangjitur gjeni certifikatat e kalibrimit të GPS të OE tjerë pjesëmarrës). Ndërsa OE “Arch Empire” L.L.C; “Eng Idea” SH.P.K ka ofruar certifikatën e kontrollit/kalibrimit me dt.19.05.2022 që do të thotë se afati i kontrollit/kalibrimit ka qenë i skaduar para se të bëhet vlerësimi.” Si e tillë, ekspertja shqyrtuese konstaton se, pas pranimit të përgjigjeve nga kompania gjegjëse si dhe nga AK, konsideroj se OE ankuesi është i përgjegjshëm, për faktin se, gjatë analizimit të Kornizë të punës Nr. AKK 2020/01 për matje, krijim dhe regjistrim të njësive kadastrale (parcelë, ndërtesë dhe pjesë të ndërtesës), [korniza-e-punes-per-matje-krijim-dhe-regjistrim-te-njesive-kadastrale.pdf \(rks-gov.net\)](#) si dhe konfirmimit të kompanisë së licencuar lidhur me validitetin e certifikatës së kontrollit konsideroj se

certifikata është valide. Pra arsyeja e eliminimit nga AK është i pa qëndrueshëm. Kornizë të punës Nr. AKK 2020/01 për matje, krijim dhe regjistrim të njësive kadastrale (parcelë, ndërtesë dhe pjesë të ndërtesës), pika 20: Certifikimi i instrumenteve gjeodezike Për matje kadastrale mund të përdoren vetëm instrumente të certifikuar. Certifikimi i instrumenteve matëse duhet të bëhet nga institucioni apo kompania e autorizuar prej prodhuesit të instrumentit. Vërtetimi/certifikatat për instrumentin nuk duhet të jetë më e vjetër se dy vite. Instrumentet për matjet kadastrale të cilat duhet certifikuar janë: 1. Instrumentet GNSS dhe 2. Stacion Total. Gjeodetët e licencuar, kompanitë gjeodete të licencuara dhe tekniku gjeodet i licencuar janë të obliguar që pas dy viteve pasi që është bërë certifikimi i instrumenteve, të njëjtën gjë ta përsërisin dhe certifikatën e re ta dorëzojnë në AKK tek komisioni për licencim. Në të kundërtën, d.m.th. nëse nga gjeodetët e licencuar, kompanitë gjeodete të licencuara dhe tekniku gjeodet i licencuar nuk dorëzohet dëshmia për përsëritjen e certifikimit në afatin e caktuar, atëherë automatikisht konsiderohet e pezulluar licenca e tyre deri në plotësimin e kriterit të ricertifikimit. Tutje, OE ankuesi ka parashtruar pretendime edhe për Operatorët ekonomik GEO-MAP N.SH si dhe ENG Group SHPK.

Konstatimi i dytë (II): pretendimi i dytë i OE ankues: AK ka elemnuar te gjithë OE-te me arsye te caktuara po ne do te ndalemi tek dy OE Eng Group shpk dhe N.SH. GEO-MAP qe kane çmime dukshëm me te lira se grup jone “Arch Empire” LLC dhe Eng Idea shpk. Po ju rikujtojme se vendimi për anulim i te njëjtës procedure prokurimi me titull: Shërbime Profesionale Inxhinierike -Ritender, tani me është marr për here te trete nga AK, pra dy here me pare është anuluar kjo procedure e prokurimit për shërbime te lartcekura. Anulimi i kësaj procedure te prokurimit me date 21.06.2023 ka ndodhur mbështetur edhe ne vendimin e OSHP-se nr. 2023 0291. Arsyeja e anulimit te procedurës se lartcekur është bere nga AK me arsyen si me poshtë: Rezultati i aktivitetit të prokurimit: Policia e Kosovës anulon aktivitetin e prokurimit me arsyetimin si në vijim: çmimet e peshuara të ofruara nga dy OE kanë qenë çmime abnormalisht të ulta se çmimet e planifikuara e të peshuara nga AK. Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e dytë sqaron, sa i përket vendimit me numër 2023/0291 pretendimi i OE ankuesit është i qëndrueshëm, për faktin se AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit për arsye të çmimeve abnormalisht të ulëta. Pretendimi i OE ankuesit: U be i gjithë ky sqarim me sipër pasi qe AK ne këtë rast nuk ka marr fare ne konsiderate çmimet jonormalisht te ulëta te ofruar nga te dy OE-te Eng group shpk dhe N.SH. GEO-MAP. Ne njoftimin e vendimit te AK-se se te datës 27.09.2023 janë dhënë arsyetimet e eliminimit te te dy OE te lartë cekur por nuk është përfshire fakti qe këta OE përveç arsyeve te dhëna nga AK kane ofruar po ashtu çmime jonormalisht te ulët. Pas qasjes ne dokumentacion ku janë verifikuar dhe çmimet e ofruar nga te dy OE Eng group shpk dhe N.SH. GEO-MAP, përveç se vërtetohet se kane ofruar çmime jonormalisht te ulëta ne oferta e tyre ka dhe çmime abuzive. Sqarim: OE GEO MAP ne poz.1 Pika A Hartimi i projekteve ideore jep çmimin 5.00 €, ndërsa te gjitha çmimet e tjera përfshi çmimet ne piken B hartimi i projekteve kryesore-palir ofron çmime jonormalisht të ulëta. Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit te shkresave te lëndës sqaron se, në ofertën e OE Eng Group dhe GEO MAP gjenden paramasat. Në pozicionet të cilat pretendon OE ankuesi që kanë vendosur çmime abnormalisht të ulëta ekspertja shqyrtuese sqaron se, pozicionet të cilat OE ankuesi i ka përmendur në ankesë janë po të njëjtat çmime të dhëna në paramasat e tyre, kurse sa i përket vlerësimit se a janë çmime të mirëqenë, konsideroj se AK gjatë procesit të rivlerësimit të hulumtoj dhe krahasoj të njëjtat, duke respektuar dispozitat ligjore të LPP-s, kurse vlen të theksohet se arsyet e eliminimit të këtyre operatorëve ekonomik janë: Te lista e çmimeve, totali i Pjesës D konkretisht tek çmimi për njësi me TVSH i peshuar vlere e totalit është (zero), çka nënkupton se për këtë pjesë nuk ka çmim të peshuar.

OE GEO MAP N.SH: Tenderi juaj është i pa përgjegjshëm sepse nuk keni dorëzuar: Nga AK është kërkuar një Gjeodet i licencuar me minimum përvojë pune 3 vite pas licencimit, kurse OE e ka ofruar licencën në emër të kompanisë e jo në emër të gjeodetit ashtu siç është kërkuar nga AK në DT dhe në njoftimin për kontratë. Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Arch Empire" L.L.C, Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin raportit të ekspertit shqyrtues. Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe përgjigjen e dhënë nga OE ankues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Arch Empire" L.L.C, janë të bazuara.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues nuk është deklaruar lidhur me raportin e ekspertizës, ndërsa OE deklaron se pajtohet me rekomandimin e ekspertit shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik nr.83/20, e datës, 03.03.2020, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, ka administruar si prova: Raportin e Ekspertit Shqyrtues, ankesa e Operatorit Ekonomik, Njoftimin për Kontratë, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, për aktivitetin e prokurimit, Raportin e Vlerësimit të Komisionit Vlerësues të AK, Vendimin e Autoritet Kontraktues lidhur me Kërkesën për rishqyrtim.

Paneli shqyrtues bazuar në konstatimet e raportit të ekspertit shqyrtues, vëren se aktiviteti i prokurimit është anuluar nga Autoriteti kontraktues me arsyetimin se, asnjë ofertë nuk është e përgjegjshme, ndërsa Operatorin ekonomik ankues e ka eliminuar për certifikatën e kontrollit të cilën Autoriteti Kontraktues e ka vlerësuar si dokument jo valide. Mirëpo pas hetimit të saj dhe sqarimeve të kompanisë së licencuar si dhe pas verifikimit të kornizës së punës; <https://akk.rks-gov.net/storage/app/media/Doracake%20profesional/korniza-e-punes-per-matje-krijim-dhe-regjistrim-te-njesive-kadastrale.pdf> pika 20, shihet se këto certifikata kanë validitet deri në dy vite, andaj OE ankues sa i përket kësaj certifikate nuk mund të eliminohet, prandaj pretendimi ankimor është i bazuar dhe aktiviteti i prokurimit duhet të kthehet në rivlerësim duke e anuluar vendimin e AK-së për anulim të këtij aktiviteti.

Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues "Arch Empire" L.L.C, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, sipas të cilit të gjitha pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik ankues, janë konstatuar si të bazuara.

Paneli shqyrtues konstaton se Autoriteti Kontraktues, Policia e Kosovës, nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit, andaj Paneli përfundimisht ka vendosur për të aprovuar ankesën e Operatorit Ekonomik dhe të anulohet "Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues" datës, 27.09.2023, Autoritetit Kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit nr; "214-23-6903-2-2-1". dhe lënda kthehet në Ri-tenderim.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të ankesës, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar, Operatorit ekonomik ankues, bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, dhe nenin 105 nenin të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - POLICIA E KOSOVËS**
- **OE - ARCH EMPIRE L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: